

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 6 paragrafi 1 pika 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.10/2019), nenit 26 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 1 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 5 paragrafi 6 të Rregullores nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, Kuvendi Komunal i Graçanicës, në mbledhjen e katërt të rregullt, e mbajtur më datën 29.04.2025, merr këtë:

VENDIM NR.26/2025/KG

për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës Ndërmarrjes publike-komunale "Ekologjia" Sh.A.

Neni 1

Miratohet Vendimi për dhënien në shfrytëzim të një pjese të parcelës kadastrale nr. 17-10 ZK Graçanicë me një sipërfaqe prej 40 ari Ndërmarrjes publike komunale "Ekologjia" Sh.A., me numër të biznesit 810081729, për ndërtimin e ndërtesës administrative dhe parkingut për automjete dhe mekanizim.

Neni 2

Prona e përmendur në nenin 1 të këtij vendimi jepet në shfrytëzim falas për periudhën kohore prej 99 vitesh, pa zhvilluar procedura paraprake.

Neni 3

Ndërmarrja publike-komunale "Ekologjia" Sh.A. është 100% në pronësi të Komunës së Graçanicës.

Neni 4

Me dhënien e pronës së paluajtshme të komunës Ndërmarrjes publike-komunale "Ekologjia" Sh.A. arrihet interesi publik, sepse me ndërtimin e ndërtesës administrative dhe

parkingut për automjete dhe makineri do të rritet niveli i shërbimeve që ndërmarrja ofron për personat fizikë dhe juridikë.


Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi janë përgjegjës drejtoritë komunale.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit



Milan Dimitrijević